

OLTA XHAÇKA



Datëlindja: 25.12.1979

Vendlindja: Tiranë

Email: Olta.Xhaka@parlament.al

Jetëshkrimi:

Znj. Olta Xhaka ka përfunduar studimet e larta me titull nderi në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, si dhe studimet pasuniversitare Master në Administrim Publik, pranë Clark University në Masaçusets të SHBA-së.

Përpara angazhimit të saj politik, znj. Xhaka ka qenë pjesë aktive e shoqërisë civile, në fushën e të drejtave të njeriut dhe mirëqeverisjes, si dhe ka punuar lektore e shkencave politike në Universitetin e New York Tirana (2012-2014).

Prej vitit 2009, znj. Xhaka është pjesë e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, fillimisht si përfaqësuese e Qarkut të Korçës për dy legjislatura në Kuvendin e Shqipërisë dhe në qershor 2017 është zgjedhur përfaqësuese e Tiranës në Kuvendin e Shqipërisë.

Znj. Xhaka është anëtare e Kryesisë së Partisë Socialiste dhe Kryetare e Forumit të Gruas së Partisë Socialiste, që prej vitit 2010.

Ajo është pjesë aktive e shoqërisë civile, kryesisht në fushën e të drejtave të njeriut dhe mirëqeverisjes.

Si aktiviste e të drejtave të njeriut, kryesisht në fushën e barazisë gjinore dhe si kryetare e Forumit të Grave Socialiste, znj. Xhaçka ka drejtuar prej vitit 2014 Nënkomisionin Parlamentar për Çështjet e të Miturve, Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje dhe ka qenë anëtare e Komisionit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë.

Që prej janarit 2021, znj. Xhaçka mban postin e ministres për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Në shtator 2017 deri në janar të vitit 2021 mbajti funksionin e Ministrit të Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë. Ndërsa më herët për një periudhë të shkurtër kohore mars 2017-maj 2017 ajo drejtoi Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.